Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)	

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					



<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike, parametrat etj

#### **Semundjet kryesore qe verehen ne druret dhe shkurret ne hapsirat e gjelbera jane:**

1. Sëmundje e Hirit, vihet re tek druret e llojeve Rrap, Geshtenje, Panje, tek shkurret e llojeve, Llargerstroemia, tek Trendafilat etj..
2. Kalbëzimi, vihet re rendom sidomos tek Kumbullat e Kuqe,
3. Brezhda e Vogel dhe
4. Brazhda e Madhe

#### **Dëmtuesit kryesore qe verehen ne druret dhe shkurret ne hapsirat e gjelbera jane:**

1. Karkaleci, i cili prek dhe demton pothuaj gjithë druret dhe shkurret
2. Krimbi i Gjelber
3. Morri Jeshil dhe
4. Morri i Zi

Shumë preparate janë krijuar për të mbrojtur pemët dhe shkurret, efektiviteti i të cilave është konfirmuar tashme nga përdoruesit e mirembajtjes se gjelberimit.

➤ **Ndër insekticidet që tregojnë rezultatet më të larta dhe mund të perdoret sipas listes se pmb-ve të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Rrepublicën e Shqipërisë jane:**

Pirimiphos methyl 50EC Insekticid, me spektër të gjerë përdorimi. vepron në mënyrë të shpejtë nëpërmjet kontaktit dhe avujve.

Lënda vepruese: Pirimiphos methyl  
PËRMBAJTJA: Pirimiphos methyl: 50%  
Lëndë ndihmëse: 50%  
Numri i regjistrimit: AL: 5/2-14.11.2008  
KS: 100-0771-11-2007/10.03.2007

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm

Fusha e përdorimit përfshin pemët dhe bimët zbukuruese dhe kunder insekteve si; Morrat, Vemjet, Tripsat, Tartabiqet, Këpushat Krahëbardhat, Çimkat, Breshkëzat, Pleshtat, etj.. Përdoret 0,1 - 0,2 litra Pirimiphos methyl 50 EC për dynym. Kur bëhen trajtime tokësore përdoren 50 - 70 litra ujë për dynym. Në rastin e spërkatjeve ajrore përdoren 0.2 – 0.3 litra ujë për dynym. Gjatë trajtimit të sigurohet një lagje e mirë e masës vegjetative.

Abamektin 1.8 % deri 1 liter per hektar. Abamektina 1.8.% është një akaricid- insekticid që ka një spektër të madh veprimi. Shkatërron akaricidet dhe ka mundësi për ta përdorur atë në zona të mëdha. Eliminimi i dëmtuesve pas përpunimit ndodh brenda 6 orëve, efekti zgjat të paktën 2 javë. Numri i trajtimeve është 1 ose 2 here.

Sperkatje me insekticide për mbrojtjen ndaj insekteve të ndryshme si: Morrat, Vemjet, Tripsat, Tartabiqet, Këpushat Krahëbardhat, Çimkat, Breshkëzat, Pleshtat në objektet si me poshte vij

---

MASAT PARAMBROJTËSE -Evitoni kontaktin me gojën, sytë dhe lëkurën. -Evitoni thithjen e tretësirës spërkatëse me anë të frymëmarrjes. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë spërkatjes. -Para fillimit të spërkatjes vishni pajisje mbrojtëse. -Lani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani ose të pini, si dhe pas përfundimit të spërkatjes. -Lani pajisjetmbrojtëse para përdorimit tjetër. -Ruajeni vetëm në ambalazhin fillestar, në vende të sigurta, largfëmijëve, pijeve dhe ushqimeve për njerëzit dhe kafshët.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN: -Në rast kontakti me preparatin lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun. -Në rast se gjatë spërkatjes nuk ndjeheni miredhe në rast gëlltitje mos shkaktoni të vjella, çojeni të aksidentuarin tek mjeku dhe i tregoni atijetiketën. Antidot: Atropina, PAM, TOXOGONIN.

Këtu kemi dozën për 1 spërkatje. Eshtë e nevojshme që të bëhen minimumi 6 deri në 8 trajtime.

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:**

**Afatet e ekzekutimit: 75** (shtatedhjetë e pesë) **dite nga data e nënshkrimit të kontratës**

Grafiku i shërbimeve dhe ekzekutimit bashkelidhur **DST**

## Shtojca 7

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCES**

- 
- Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “**Sherbime Agro-Teknike (Fitopatologjike dhe Entomologjike)**”, për nevojat e DPPGJ per vitin 2022.

Ky shërbim kërkohet duke u nisur nga vetë natyra e punës që kryen Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit, në terren, kudo ku lind nevoja. Sektori i Zhvillimit dhe Mirembajtjes së Gjelberimit të Qytetit, është i rëndësishëm në këtë Drejtori, për vetë rolin që luan në dhënien e zgjidhjeve të shumë problematikave të hasura në komunitet. Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), Neni 156”; Vendimit Nr.41, datë 23.09.2015 të Këshillit Bashkiak për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; Urdhërit Nr.Prot.16365/1, datë 29.04.2022 për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë”, Urdhërit Nr.16364/1, datë 29.04.2022, për “Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit”, Insitucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

Fitopatologjia, e njohur gjithashtu si patologji bimore, është shkencë që diagnostikon dhe kontrollon sëmundjet e bimëve dhe përfshin agjentët infektivë që sulmojnë bimët dhe sëmundjet fiziologjike ose çrregullimet abiotike.

Ekspertët vlerësojnë se sëmundjet e bimëve shkaktojnë një humbje prej 10% të prodhimit të ushqimit në të gjithë botën.

Ekzistojnë dy lloje faktorësh që mund të shkaktojnë sëmundje te bimët: **Biotik dhe abiotik**. Ne do t'i komentojmë të dy më poshtë.

#### **Faktorët biotikë**

Kur flasim për faktorët biotikë, ne u referohemi organizmave të gjallë që ndikojnë në një ekosistem. Lidhur me bimët, ato mund të ndikohen nga sa vijon:

- **Lloje të ndryshme të kërpudhave**
- **Prokariotët (bakteret)**
- **Viruset dhe viruset**
- **Nematodat**
- **Protozoarë**
- **Bimë parazitare**

Të gjitha këto kanë kapacitetin për të depërtojnë dhe shpërndahen në një organizëm pritës të bimëve. Në rast se faktorët abiotikë po shkaktojnë fitopatologjinë, ajo zhvillohet në gjithsej tetë faza:

1. Kontaminimi: Agjenti infektiv afrohet te bima pritëse.
2. Depërtimi: Pastaj depërton në bimë përmes indeve të shëndetshme, plagëve ose hapjeve natyrore.
3. Infeksioni: Patogjeni bie në kontakt me qelizat e bimës së depërtuar.
4. Inkubacioni: Ky është intervali kohor midis infeksionit dhe shfaqjes së simptomave.
5. Përhapja: Agjenti infektiv përhapet në indet e tjera të bimës.
6. Riprodhimi: Brenda bimës pritëse, patogjeni fillon të riprodhohet.
7. Shpërndarja: Agjentët e rinj infektivë shpërndahen në mes në mënyrë që të kolonizojnë bimë të tjera.
8. Mbijetesë: Këto patogjenë mbeten në mes për sa kohë që kushtet nuk janë të përshtatshme për të infektuar një fabrikë të re pritëse.

#### **Faktorët abiotikë**

Nga ana tjetër, sëmundjet në perime gjithashtu mund të shkaktohen nga faktorë abiotikë.

Domethënë: Për arsye natyrore fizike të tilla si, për shembull, përmbytjet ose zjarret.

Veprimi njerëzor është përfshirë gjithashtu në këtë grup, një nga më të rëndësishmit është



---

ndotja. Kështu, këta janë faktorë që nuk sulmojnë direkt bimën, nëse jo mjedisin e saj. Përveç kësaj, në shumë raste ato mund të shmangen nëse kryhet kujdesi i duhur. Në mes faktorët natyrorë janë si më poshtë:

- **Thatësira**
- **Ngrirja**
- **Përmytjet**
- **Mungesa e lëndëve ushqyese**
- **Minerale të tepërta të tretshëm**
- **Depozitimi i kripës**
- **Viento**
- **Teprica ose mungesa e ndriçimit**
- **Zjarret në pyje**
- **Helmimi i shkaktuar nga agjentë të ndryshëm kimikë**

Lidhur me faktorët që përfshijnë veprimi njerëzor ne kemi këto:

- Ngjeshja e tokës
- Ndotja, si ajri ashtu edhe toka
- Herbicide
- Mungesa e trajnimit të njerëzve që administrojnë bimët

Cila është rëndësia e patologjisë së bimëve?

Rëndësia e studimeve mbi sëmundjet e bimëve është jetike, nëse sëmundjet e bimëve nuk trajtohen në kohë, ato mund të shkaktojnë humbje ekonomike që do të përfundonin duke prekur të gjithë shoqërinë dhe standardin e jetesës së njerëzve. Padyshim, humbjet varen nga lloji i produktit, speciet bimore, agjenti dëmtues dhe koha që duhet për të diagnostikuar atë.

Është e pamohueshme që patologjitë e bimëve kanë arritur të ndryshojnë zakonet e popullatave të ndryshme, veçanërisht kur përfshihen faktorë abiotikë.

Mbrojtja e bimëve. Preparatet që përdoren për sëmundjet dhe dëmtuesit mund të pakësohen shumë përmes një zgjedhje të mirë të bimëve dhe bimët që i rezistojnë sëmundjeve dhe dëmtuese duhen zgjedhur në çdo rast që kjo është e mundur. Etiketat e shumë bimëve në kohët e sotme përmbajnë edhe informacion mbi rezistencën e bimëve ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe këtë informacion e kanë edhe shumica e librave të kësaj fushe apo e faqeve të internetit.

Disa specie që janë në fidanishtet e bimëve dekorative zgjidhen specifiku për shkak se kanë këto karakteristika. Projektuesit që i përfshijnë këto specie në projektet e tyre mund të pakësojnë shumë nevojën për preparate që kontrollojnë sëmundjet e dëmtuesit gjatë gjithë jetës së peizazhit

Entomologjia

Është shkencë, e cilamerret me studimin e insekteve. Fjala entomologji rrjedh nga fjalët greke:

*entomon* – insekt dhe *logos* – shkencë (dije). Ndahet në dy pjesë kryesore: e përgjithshme dhe e posaçme. Entomologjia e përgjithshme studion zanafillën, historikun, ndërtimin, zhvillimin, shumimin dhe ndikimin e ambientit të jashtëm në zhvillimin e insekteve.

Entomologjia studion insektet dëmtuese të bimëve dhe produkteve të tyre. Kurse, Fitomedicina merret me mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit, shkaktarët e sëmundjeve dhe barërat e këqija.

Metodat kimike të luftimit

Metoda kimike e luftimit konsiston në përdorimin e substancave kimike që kanë veprim toksik në insekteve.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e metodës kimike të luftimit ka luajtur dhe luan zbulimi i preparateve të ndryshme të cilat mbi bazen e objektit ku veprojnë ndahen në:

- 
- Insekticide, kunder insekteve
  - Akaricide, kunder riqnave
  - Ovicide, kunder vezeve
  - Larvicide, kunder larvave
  - Repelente, substance per te trembur
  - Atraktante, substance ndjellese

Te gjitha keto ne kompleks emertohen Pesticide

Sipas menyres se depertimit ne organizen dhe karakterit te veprimit pesticidet ndahen me veprim te brendshem dhe helm kontakti ose me veprim te jashtem, fumigante te cilet veprojne ne sistemin e frymemarrjes dhe helme sistemi qe veprojne ne limfen e bimeve. Rezultati i metodes kimike te luftimit kushtezohet nga sasia e inskticidit, koha, forma e preparatit, kushtet e ambjentit, nga temperatura, lageshtia, toka, etj, si dhe nga lloji dhe faza e demtuesit.

Ne ushtrim te detyrave te perditshme specialistet e gjelberimit ne sektoret sipas njesive administrative, bazuar edhe ne vrojtimet e viteve te meprashme verejne se ka tendenca te shtimit te semundjeve dhe demtueseve te drureve dhe shkurreve ne hapsirat e gjelbera si; ne gjelberimin linear pergjate lumit Lane, ne lulishten tek fusha Ali Demi, ne lulishten Qemal Stafa, ne lulishten Vellezerit Frasherit, ne lulishten Sitki Cico, ne lulishten tek ish fusha e Aviacionit, lulishte tek Cajupi, tek Stadiumi Dinamo, druret dhe shkurret pergjate lumit te Tiranes, Kumbullat e Kuqe ne rrugen e Kavajes etj., te gjitha keto kerkojne trajtime me preparate te ndryshme kimike te luftimit te semundjeve dhe demtueseve.

#### **Detyrat:**

- Kryerja e Shërbimit me objekt prokurimi: "Shërbime **Agroteknike (fitopatologjike dhe entomologjike)**" do te kryhen sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Dezinfetimi do të bëhet në segmente të ndryshme, të përcaktuara në bazë të grafikut nga AK (sektori përkatës).

**Shpërndarja:** Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë **75 (shtatedhete e pese) ditë nga data e nenshkrimit të kontratës.**

**Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:** Vendi dhe dorezimi i shërbimeve do te ndiqet nga grupi i punes qe do te ngrihet per zbatimin e ketij objekt prokurimi i llojit shërbim duke zbatuar grafikun e ekzekutimit te ndare ne zonat perkatese sipas tabelave me perpikmeri nga operatori ekonomik fitues.

*DEZINFEKTIMI eshte pasyruar ne menyre tabelare si me poshte vijon;*

**Spërkatje me insekticid:**

				Drure dhe shkurre ne cope		Doza e insekticidit
	Objekti i mesit, Rruga Bardhyl Ferit	INSEKTICIDE			Gjithsej ha	liter/ha
1	Lumi Lana Xhaxho Reshit	Pirimiphos methyl 50EC		3000	10	2
2	Lumi Lana Petrela Muhamet	Abamectin 1.8 EC	15000	3000	10	1,5
	Gjollësha				1	
	Autostrada Tirane_Qafe					
15	Lulishte tek Kashar	Pirimiphos methyl 50 EC	200	2300	0,43 10	2 2
	Dervish Luzha					
	Autostrada Tirane_Qafe					
16	Lulishte tek Kashar	Abamectin 1.8 EC	200	2300	0,43 10	1,5 1,5
	Dervish Luzha					
5	Fusha Ali Demi	Pirimiphos methyl 50 EC		250	0,8	2
15	Lumi Tirana	Pirimiphos methyl 50 EC	850		3	2
6	Fusha Ali Demi	Abamectin 1.8 EC		250	0,8	1,5
16	Lumi Tirana	Abamectin 1.8 EC	850		3	1,5
7	Lulishte tek				0,8	2
17	Blloku i Ambasadave Parlamenti	Pirimiphos methyl 50 EC	120	245	0,4	2
18	Blloku i Ambasadave	Abamectin 1.8 EC	120		0,4	1,5
8	Lulishte tek				0,8	1,5
19	Kombinat Rr.Llazi Parlamenti	Pirimiphos methyl 50 EC	450	245	1,5	2
		Abamectin 1.8 EC		245		
19	Kombinat Rr.Llazi Lulishte Qemal Miho	Abamectin 1.8 EC	450	180	1,1	1,5
	Stafa					
21	Bulevardi Zogu I	Pirimiphos methyl 50 EC	505		1,5	2
10	Lulishte Qemal			180	1	1,5
22	Bulevardi Zogu I	Abamectin 1.8 EC	505		1,5	1,5
	Stafa	Abamectin 1.8 EC				
23	Bulevardi i Ri	Pirimiphos methyl 50 EC	284		1	2
11	Bulevardi i Ri Ruga e Kavajës	Abamectin 1.8 EC	284	60	1 0,1	1,5 2
25	Kryesia e Kuvendit	Pirimiphos methyl 50 EC	100		0,3	2
12	Rruga e Kavajës	Abamectin 1.8 EC		60	0,1	1,5
26	Kryesia e Kuvendit	Abamectin 1.8 EC	100		0,3	1,5
27	Presidenca	Pirimiphos methyl 50 EC	500		1,7	2
28	Presidenca	Abamectin 1.8 EC	500		1,7	1,5
	Parteri i mesit,					
29	Kryeministria Rruga Bardhyl_Ferit	Pirimiphos methyl 50 EC	95		0,3	2
30	Xhaxho Reshit	Abamectin 1.8 EC	95		0,3	1,5
13	Petrela Muhamet	Pirimiphos methyl 50 EC		15000		2
31	Lulishtet TOB,Ushtari Gjollësha Panjohur	Pirimiphos methyl 50 EC	60		0,3 1	2

32	Lulishtet TOB,Ushtari Panjohur	Abamectin 1.8 EC	60	0.3	1,5
33	Rr.Siri Kodra	Pirimiphos methyl 50 EC	304	1	2
34	Rr.Siri Kodra	Abamectin 1.8 EC	304	1	1,5
35	Kopshti 62,56,24,3,36,6,19,35, 42,25/1,11,4 Stinet,41,18,1,20,29,22, 25/A,27/A,39,55,51,14, 28,K.Kamez, K.Bregu i Lumit	Pirimiphos methyl 50 EC	1154 Peme  922 Shkurre	3.5	2
36	Kopshti 62,56,24,3,36,6,19,35,8, 42,25/1,11,4 Stinet,41,18, 1,20,29,22,25/A,27/A,3 9,55,51, 14,28,K.Kamez, K.Bregu i Lumit	Abamectin 1.8 EC	1154 Peme  922 Shkurre	3.5	1,5
37	Cerdhe 14,60,50,51,45,13,1,8,5 7,41,54,56,26,15,19,42, 48,11,30,58,59	Pirimiphos methyl 50 EC	531 Peme  469 Shkurre	1.5	2
38	Cerdhe 14,60,50,51,45,13,1,8,5 7,41,,54,56,26,15,19,42, 48, 11,30,58,59	Abamectin 1.8 EC	531 Peme  469 Shkurre	1.5	1,5
39	Rr.Sami Frasheri	Pirimiphos methyl 50 EC	174 Peme	0.5	2
40	Rr.Sami Frasheri	Abamectin 1.8 EC	174 Peme	0.5	1,5

Sperkatje me fungicide per mbrojtjen ndaj smundjeve te ndryshme si:hyret,ndrishqet,kromat nekrozat, septeriozat,etj

Nr	Objekti	Fungicide	Drure dhe cope	Gjithsej ha	Doza e fungicidit liter/ha
1	Lumi Lana	penconazole 10ec	3000	10	2

2	Lumi Lana	difenoconazole 25%	3000	10	1
3	Autostrada Tirane_Qafe Kashar	penconazole 10ec	2300	10	2
4	Autostrada Tirane_Qafe Kashar	difenoconazole 25%	2300	10	1
5	Fusha Ali Demi	penconazole 10ec	250	0,8	2
6	Fusha Ali Demi	difenoconazole 25%	250	0,8	1
7	Lulishte tek Parlamenti	penconazole 10ec	245	0,8	2
8	Lulishte tek Parlamenti	difenoconazole 25%	245	0,8	1
9	Lulishte Qemal Stafa	penconazole 10ec	180	1	2
10	Lulishte Qemal Stafa	difenoconazole 25%	180	1	1
11	Rruga e Kavajës	penconazole 10ec	60	0,1	2
12	Rruga e Kavajës	difenoconazole 25%	60	0,1	1
13	Lulishte tek Dervish Luzha	penconazole 10ec	200	0,43	2
14	Lulishte tek Dervish Luzha	difenoconazole 25%	200	0,43	1
15	Lumi Tirana	penconazole 10ec	850	3	2
16	Lumi Tirana	difenoconazole 25%	850	3	1
17	Blloku i Ambasadave	penconazole 10ec	120	0,4	1
18	Blloku i Ambasadave	difenoconazole 25%	120	0,4	2
19	Kryesia e Kuvendit	penconazole 10ec	100	0,3	2
20	Kryesia e Kuvendit	difenoconazole 25%	100	0,3	1
21	Presidenca	penconazole 10ec	500	1,7	2
22	Presidenca	difenoconazole 25%	500	1,7	1
23	Kryeministria	penconazole 10ec	95	0,3	2

24	Kryeministrai	difenoconazole 25%	95	0,3	1
25	Lulishtet TOB,Ushtari Panjohur	penconazole 10ec	60	0.3	2
26	Lulishtet TOB,Ushtari Panjohur	difenoconazole 25%	60	0.3	1
27	Kombinat Rr.Llazi Miho	penconazole 10ec	450	1.5	2
28	Kombinat Rr.Llazi Miho	difenoconazole 25%	450	1.5	1
29	Bulevardi Zogu I	penconazole 10ec	505	1.5	2
30	Bulevardi Zogu I	difenoconazole 25%	505	1.5	1
31	Bulevardi i Ri	penconazole 10ec	284	1	2
32	Bulevardi i Ri	difenoconazole 25%	284	1	1
33	Rr.Siri Kodra	penconazole 10ec	304	1	2
34	Rr.Siri Kodra	difenoconazole 25%	304	1	1
35	Kopshti 62,56,24,3,36 ,6,19,35, 42,25/1,11,4 Stinet,41,18, 1,20,29,22,25 /A,27/A,39,5 5,51, 14,28,K.Kam ez, K.Bregu i Lumit	penconazole 10ec	1152 Peme  922 Shkurre	3.5	2
36	Kopshti 62,56,24,3,36 ,6,19,35, 42,25/1,11,4 , 14,28,K.Kam ez, K.Bregu i Lumit Stinet,41,18, 1,20,29,22,25 /A,27/A,39,5 5,51	difenoconazole 25%	1152 Peme  922 Shkurre	3.5	1
37	Cerdhe 14,60,50,51,4 5,13,1, 8,57,41,,54, 56,26,15,19,4 2,48, 11,30,58,59	penconazole 10ec	531 Peme  369 Shkurre	1.5	2

38	Cerdhe 14,60,50,51,4 5,13,1, 8,57,41,,54, 56,26,15,19,4 2,48, 11,30,58,59	difenoconazole 25%	531 Peme  469 Shkurre	1.5	1
39	Rr.Sami Frasheri	penconazole 10ec	174 Peme	0.5	2
40	Rr.Sami Frasheri	difenoconazole 25%	174 Peme	0.5	1

**Sperkatje me fungicide per mbrojtjen sëmundjeve te ndryshme qe prekin druret dhe shkurre si dhe gjelberimin ne teresi.**

	<b>Objekti</b>	<b>Fungicid</b>	<b>Drure dhe shkurre ne cope</b>	<b>Gjithsej ha</b>	<b>Doza e fungicidit kg/ha</b>
1	<i>Lumi Lana</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	3000	10	4
2	<i>Autostrada Tirane_Qafe Kashar</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	2300	10	4
3	<i>Fusha Ali Demi</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	250	0.8	4
4	<i>Lulishte tek Parlamenti</i>	<i>metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	245	0.8	4
5	<i>Lulishte Qemal Stafa</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	180	0,8	4
6	<i>Rruga e Kavajës</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	60	0,1	4
7	<i>Parteri i mesit, Rruga Bardhyl_Ferit Xhajko_Reshit Petrela_Muhamet Gjollesha</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	15000	1	4

8	<i>Lumi Tirana</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	850	3	4
9	<i>Blloku i Ambasadave</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	120	0,4	4
10	<i>Kryesia e Kuvendit</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	100	0,3	4
11	<i>Presidenca</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	500	0.5	4
12	<i>Kryeministria</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	95	0,3	4
13	<i>Lulishtet TOB,Ushtari Panjohur</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	60	0.3	4
14	<i>Kombinat Rr.Llazi Miho</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	450	1.5	4
15	<i>Bulevardi Zogu I</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	505	1.5	4
16	<i>Bulevardi i Ri</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	284	1	4
17	<i>Rr.Siri Kodra</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	304	1	4
18	<i>Kopshti 62,56,24,3,36,6,19 ,35, 42,25/1,11,4 Stinet,41,18, 1,20,29,22,25/A,2 7/A,39,55,51, 14,28,K.Kamez, K.Bregu i Lumit</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	1152 Peme  922 Shkurre	3.5	4
19	<i>Cerdhe 14,60,50,51,45,13, 1, 8,57,41,,54, 56,26,15,19,42,48, 11,30,58,59</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i> <i>baki 40.</i>	531 Peme  469 Shkurre	1.5	4
20	<i>Rr.Sami Frasheri</i>	<i>Metalaxyl-M 2,5.Oksikloru</i>	174 Peme	0.5	4



---

		<i>baki 40.</i>			
--	--	-----------------	--	--	--

**Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

---

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

---

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% te vleres se fondit limit)*
- c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. *Formulari sherbimeve dhe grafikut ekzekutimit sipas shtojces 6;*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (, sipas shtojcës 8)

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2019,2020,2021) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operateve ekonomike **nuk mund të tejkalojë 40%** të vlerës së parashikuar te kontrates.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021)**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

#### 2.3 Kapaciteti teknik:

---

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

\* Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

\* Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë II.5.A për tregtim të produkteve të mbrojtjes së bimëve.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë II.8.B për “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore

**Shënim:**

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacionin e kërkuar.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i **Certifikuar sipas standardeve ISO** të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për të përmbushur këto kriter duhet të paraqesi konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**, (ose ekuivalente) (e vlefshme) **me të OHSAS 18001-2007**

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e këtij shërbimi objekt kontrate duhet të disponojë të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të punësuar**, ku të paktën **5 (pesë)** të jenë të trajnuar për shërbime dezinfektimi dhe të paktën **5 (pesë)** të jenë të trajnuar për shërbime gjelbërimi (certifikata trajnimesh perkatëse) **për 3 muajt e fundit** të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjisllacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës. .

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **te punësuar nje staf teknik mbështetës te kualifikuar** të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) inxhinier pyjesh
- 2 (dy) agronomë
- 3 (tre) shoferë, të paktën 1 shofer me Dëshmi Aftësie Profesionale automakinist
- 10 (dhjetë) punonëtorë

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (afati i vlefshmërisë së kontratave të punës duhet të jetë për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës)
- Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore, për periudhën Maj 2022 – Korrik 2022.
- Diplomë ose / dhe çertifikata trajnimesh. Këto dokumenta duhet të jenë të lëshuara nga institucione të njohura ose akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një *1 (nje) Specialist per pergjegjesine dhe shendetin ne pune eshte në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar), i cili duhet te beje trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit teknik përpara fillimit të procesit të punës. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vetë trajnimin (dhe të paraqesë certifikatën përkatëse për kryerjen e trajnimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose të ketë lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime te tilla apo një punonjës të brendshëm si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues.*

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet e transportit që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si vijon;

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autokullë me kosh mbi 20 metra	$\geq 1$ copë	Pronësi ose me qira
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Gërshërë	$>5$ copë	Pronësi ose me qira
4	Pompa të montueshme në pick-up	$\geq 2$ copë	Pronësi ose me qira
5	Motorrsek për krasitje në lartësi	$> 1$ copë	Pronësi ose me qira
6	Pompa shpine	$\geq 5$ copë	Pronësi ose me qira
7	Shkallë për ngjitje në lartësi	$>1$ copë	Pronësi ose me qira
8	Pajisje të sigurisë në punë (jelekë, kaska/kapele, syze etj)	$>10$ copë	Pronësi ose me qira

- 
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi, ndërsa për vincin me kosh të paraqitet edhe raporti i inspektimit të konformitetit të krahut së bashku me specifikimet teknike të krahut (të përkthyer dhe të noterizuara) ku të tregohet lartësia mbi 20 metra.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **Shtojca 9.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• <b>Informacione për nënkontraktorin</b>			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

